



Kolegji FAMA
Gustav Majer 7 ,10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 - (0)38 - 222 212
Email: info@kolegjifama.eu



Instituti për zhvillim dhe Bashkëpunim
Ekonomik Ndërkombëtar **IZHEN FAMA**
Email: izhen.fama@gmail.com

ROLI I KPMM-SË NË ZHVILLIMIN E INDUSTRIË SË MINIERAVE NË KOSOVË

Prishtinë
MAJ, 2012

**Hulumtimi u mbështet nga
ekipi hulumtues:**

Bekim Marmullaku
Demir Limaj
Luigj Dedaj
Antigona Çunaku

Autorë:

Haradin Gervalla
Bedri Drini

Intervistat dhe bisedat u zhvilluan nga studentët e nivelit Master të Kolegjit FAMA

Hulumtimi u përkrah dhe u financua nga Kolegji FAMA dhe IZHBEN-FAMA

Falënderime

Ky hulumtim është realizuar nga ekipi profesional dhe kolegët tjerë në Institutin për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik Ndërkombëtar IZHBEN – FAMA.

Kontribut shtesë kanë dhënë edhe studentët e nivelit Master të Kolegjit Fama nga qendrat e saj në Prishtinë, Prizren, Gjilan dhe Mitrovicë si dhe profesorë të këtij kolegji. IZHBEN – FAMA dëshiron që posaçërisht të falënderojë Kolegjin Fama për përkrahjen dhe financimin e këtij hulumtimi. Gjithashtu, falënderojmë në mënyrë të veçantë, Institucionet përkatëse që kanë dhënë informata hulumtuese për këtë hulumtim.

Ekipi hulumtues
Qershor,2012

Shkurtesat:

UNMIK	United Nations Mission in Kosovo
KPMM	Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
PSSP	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
GIS	Geographic Information System
GDK	Gjeodatabaza e Kosovës
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MEM	Ministria energjisë dhe Minierave
TSHM	Tantiema për shfrytëzimin e Minierave
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës

Tabelat dhe Figurat:

Tabelat:

Tabela 1. Licencat/lejet e lëshuara nga KPMM sipas viteve dhe llojit të licencave/lejeve

Tabela 2. Krahasimi i të hyrave dhe Shpenzimeve në vitet 2006-2010

Tabela 3. Mesatarja e tantimës në Kosovë dhe në vendet e tjera

Tabela 4. Lista e rentës minerare e aplikuar në Kosovë nga 2001-2007

Tabela 5. Renta minerare për mineralet ndërtimore, industriale, gurë të çmuar dhe ujë mineral & termal

Figurat:

Figura 1. Licencat/lejeve e lëshuara sipas viteve

Figura 2. Krahasimi i të hyrave dhe Shpenzimeve në vitet 2006-2010

Figura 3. GDK Gjeodatabaza e Kosovës

Figura 4. Harta me intensitet magnetik nga Matjet Ajrore Gjeofizike

Figura 5. Harta e resurseve minerale të Kosovës – plansheti i Volljakut

Figura 6. Harta e resurseve minerale të Kosovës – Plansheti i Kramovikut

Figura 7. Mesatarja e rentës minerare në Kosovë dhe në vendet tjera

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

1. HYRJE.....	1
2. INDUSTRIA MINERARE E KOSOVËS.....	4
2.1. Zhvillimi i Industrisë Minerare në Kosovë.....	4
2.2. Ndikimi i Minierave në zhvillimin Ekonomik.....	5
2.3. Faktorët që ndikojnë në zhvillimin Minierave.....	6
2.4. Faktorët e brendshëm	6
2.5. Faktorët e jashtëm.....	7
3. KOMISIONI I PAVARUR PËR MINIERA DHE MINERALE.....	8
3.1. Funkcionet e Komisionit të pavarur për Miniera dhe Minerale.....	8
3.2. Organizimi i KPMM-së.....	10
3.3. Hyrjet dhe Shpenzimet e KPMM-së nga viti 2006 deri në vitin 2010.....	12
4. ROLI I KPMM-së DHE IMPLEMENTIMI I PROJEKTEVE TË FINANCUARA NGA KPMM-ja...13	
4.1. Matjet Ajrore Gjeofizike.....	15
4.2. Përpilimi i Plansheteve të Hartës Gjeologjike të Kosovës.....	15
4.3. Plani i Menaxhimit të Resurseve Minerale të Kosovës (PMRMK).....	17
5. ROLI I INSTITUCIONEVE TJERA NË ZHVILLIMIN E INDUSTRISË MINERALE NË KOSOVË.18	
5.1. Ministria e Energjisë dhe Minierave.....	18
5.2. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.....	19
5.3. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.....	20
5.4. Komunitat.....	20
5.5. Parlamenti i Kosovës.....	20
6. RENTA MINERARE (TANTIEMA).....	21
6.1. Kriteret për caktimin e rentës minerare.....	22
6.2. Caktimi i rentës minerare.....	23
6.3. Ndikimi i Rentës Minerare në Buxhetin e Kosovës.....	27
6.4. Ndikimi i rentës minerare në tërheqjen e investimeve të huaja.....	29
7. KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME.....	30

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Zhvillimi i shkencës dhe aplikimi i të arriturave të saj në prodhimtari gjithnjë po e zgjerojnë rrethin e materieve minerale, të cilat fitojnë cilësi të materieve të dobishme dhe bëhen lëndë të punës për sigurimin nevojave të njerëzve.

Kosova posedon resurse nëntokësore si dhe ka një potencial të fuqishme për zhvillimin ekonomik.

Kosova është një ndër vendet më të pasura evropiane me potenciale energjetike (linjit). Valorizimi optimal dhe racional me ekonomizim të mirëfilltë të resurseve natyrore dhe atyre humane do të mundësonte që Kosova të ketë një perspektivë të zhvillimit të përgjithshëm ekonomik të nivelit shumë të lartë krahasuar me shtetet fqinje të rajonit.

Me qëllim që këto resurse të shfrytëzohen sigurt në vazhdimësi dhe sa më me efektivitet në vitin 2005 është themeluar Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2005/2, ndërsa aktualisht funksionon në bazë të Ligjit Nr. 03/L-081.

Më 16 qershor të vitit 2008 është dekretuar Ligji Nr. 03/L-081 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2005/2 mbi Themelimin e Komisionit të Pavarur për Minierat dhe Minalet, dhe nga ajo datë KPMM i përgjigjet dhe i raporton Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Në këtë hulumtim, në mënyrë të detajuar janë paraqitur zhvillimet e industrisë minerare në Kosovë, faktorët që ndikojnë në zhvillimin e sektorit minerar, ndikimin e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, si dhe rolin dhe rëndësinë e Rentës Minerare në zhvillimin e këtij sektori.

Misioni i KPMM-së është të lëshojë dhe të administrojë të gjitha lejet dhe licencat për shfrytëzimin minerar, të kryej mbikëqyrjen teknike të instalimeve minerare dhe të impianteve, si dhe të përpilojë rregulloret ligjore, të sigurisë dhe shëndetit në vendet e punës.

Me qëllim që të këshillojë investitorët, KPMM bën vlerësimet e burimeve gjeologjike, këshillon investitorët për zonat potenciale të interesit dhe ofron informata për shërbime të orientuara për ndonjë çështje që ka lidhje me interes në botën e shfrytëzimit minerar.

Renta Minerare (tantiema), paraqet paratë e paguara në intervale të rregullta nga operatori i minierës pronarit të tokës (shtetit), bazuar në vlerën e mineralit në “Mine Gate” (porta

kryesore). Duke pasur parasysh se mineralet në Kosovë janë pronë e shtetit, atëherë konsiderohet se renta minerare është një pasuri e shtetit, përkatësisht përbën një pasuri publike dhe duhet të jetë pjesë e buxhetit të pushtetit qendror/ lokal¹.

Në përgjithësi ky raport analizon ndikimin dhe rolin KPMP në zhvillimin e Industrisë së Minerave dhe Mineraleve, ndikimin e Minerave në Zhvillimin Ekonomik, rolin e Institucioneve tjera në zhvillimin e industrisë minerare në Kosovë, ndikimin e rentës Minerare në buxhetin e Kosovës si dhe ndikimi i saj në tërheqjen e investime të huaja. Shqyrtimi dhe analiza këtyre të dhënave përcillet edhe me nxjerrjen e konkluzioneve dhe dhënien e rekomandimeve.

Të gjeturat kryesore të këtij hulumtimi mund të përmbledhen me sa vijon:

- Vlerësimi mbi ndikimin e KPMM-së në tërheqjen e investimeve të huaja dhe implementimi i politikave qeveritare në zhvillimin e sektorit minerar.
- Ndikimi i resorëve tjerë qeveritar në bërjen e politikave për sektorin minerar dhe strategjinë e minerave, në vlerësimin e ndikimit në mjedis të operimeve minerare.
- Roli i KPMM-së në plotësimin e mungesave në politikat e qarta në zhvillimin e sektorit minerar dhe kontributi i saj në licencimin e kompanive në përputhje me kriteret e parapara me ligj.
- Gjetja për nevojën urgjente për themelimin e “Shërbimit Gjeologjik të Kosovës” si agjencion i veçantë.
- Identifikimi i nevojës për një bashkëpunim më të madh në mes të institucioneve të Kosovës, të niveleve qeveritare dhe komunale, dhe një bashkërendim më i madh i aktiviteteve në mes të ministrive që implikohen direkt me sektorin minerar.

¹ Neni 64, Rregullorja 2005/3

1. HYRJE

Resurset minerale të një vendi janë shtylla mbështetëse për planifikim të zhvillimit ekonomik, ndërsa një rol të tillë ky sektor në të kaluarën e ka pasur edhe në Kosovë. Kosova ka potenciale të mëdha minerare të cilat kanë luajtur rol kyç në zhvillimin ekonomik të vendit, mirëpo për shkak të rrethanave shoqëro-politike në Kosovë nuk i është kushtuar rëndësia e duhur këtij sektori.

Industria minerare në Kosovë ka qenë e zhvilluar qysh prej shumë kohësh, mirëpo kryesisht pasuritë minerare të vendit janë eksploatuar dhe shfrytëzuar pamëshirshëm nga të huajt. Vetëm në dhjetë vitet e fundit industria minerare ka filluar të shfrytëzohet nga vetë kosovarët, mirëpo me vështirësi të mëdha për shkak të pasojave që kanë mbetur nga eksploatimi i mëhershëm.

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale është themeluar në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2005/2 të datës 21 janar 2005 mbi themelimin e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerare, ndërsa aktualisht funksionon në bazë të Ligjit Nr. 03/L-081.

Në bazë të ligjit për themelimin e tij, Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale është përgjegjës për licencat për eksplorim dhe shfrytëzim të minierave; licencat lidhur me shfrytëzimin e lëndëve plasëse në veprimet për shfrytëzimin e minierave; kryerjen e hetimeve lidhur me aksidentet që ndodhin në miniera, krijimin dhe mirëmbajtjen e bazës së të dhënave për titullarët e mineraleve, ofrimin e ndihmës teknike qeverisë për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me minierat dhe mineralet në Kosovë etj.

Në bazë të po këtij ligji, Komisioni i dorëzon raporte të rregullta Kuvendit të Republikës së Kosovës lidhur me të gjitha aktivitetet, duke përfshirë edhe çështjet e personelit të tij, organizimin dhe çështjet administrative.

Në praktikën botërore është e njohur së rregullatorët luajnë një rol të veçantë në zhvillimin e industrisë minerare. Rregullatorët janë themeluar në SHBA, Spanjë, Suedi, Britani e Madhe etj., si edhe në vendet postkonfliktuoze. Ndër arsyet kryesore të themelimit të këtyre institucioneve ka qenë gjetja e një sistemi të balansit në mes politikëbërjes dhe implementimit të politikave, në mënyrë që të krijohet një sistem i sigurt i investimeve, si dhe të zvogëlohet ndikimi direkt i politikës në sektorin minerar.

Rregullatorët konsiderohen si një lloj ndërmjetësuesi në mes të industrisë dhe qeverisë. Qeveria propozon strategjinë dhe politikën, Kuvendi bën aprovimin e tyre, ndërsa Rregullatori është përgjegjës për implementimin e këtyre politikave, si dhe kontrollin e funksionimit të tyre. Parlamenti, në anën tjetër, monitoron Rregullatorin nëse është duke e bërë implementimin e ligjeve, strategjisë dhe politikave minerare.

Qëllimi i hulumtimit

Qëllimi i këtij hulumtimi është shqyrtimi i ndikimit dhe rolit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale në industrinë e minierave; cilat janë specifikat e tij; ndërlidhja e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale me institucionet e tjera; çka është tantiema (royalty), si caktohet ajo dhe cili është roli i saj për buxhetin e shtetit. Pra, hulumtimi konsiston në përshkrimin e gjendjes aktuale në këtë sektor, dhe shqyrtimin e mundësive të përmirësimit në të ardhmen.

Metodologjia e hulumtimit

Realizimi i këtij punimi është i bazuar në metodat e krahasimit, në intervista dhe biseda të ndryshme me ekspertë ndërkombëtarë dhe vendorë të këtij lëmi.

Për përgatitjen e këtij raporti është shfrytëzuar literaturë nga Ekonomia, Gjeologjia, Xehetaria, të autorëve të ndryshëm vendorë dhe ndërkombëtarë, si dhe literaturë profesionale ndërkombëtare. Sa i përket ndikimit të institucioneve tjera, hulumtimi është bazuar në ligjet ekzistuese në Kosovë, në intervistat dhe bisedat me ekspertë të ndryshëm. Po ashtu, janë shfletuar faqet e internetit që kanë të bëjnë me lëmin e industrisë minerare dhe rolin e rregullatorëve në këtë industri etj.

2. Industria Minerare në Kosovë

2.1. Zhvillimi i industrisë minerare në Kosovë

Më 1928, minierat e plumbit dhe të zinkut të Kosovës bëhen pronë e Bashkësisë Ekonomike Angleze ("Selection Trust Limited") nga Londra. Kjo shoqëri aksionare angleze në Kosovë formoi tri miniera të plumbit dhe të zinkut: minierën e "Trepçës" (Trepça Mines Limited), Minierën e "Kopaunikut" (Kopaonik, Mines Limited) dhe miniera e "Novo Berdes" (NovoBrdo, Mines Limited).

Më 1929, në minierën e Trepçës në Stan Terg u zbuluan rezervat e xehes së plumbit, xehet e zinkut: 1.750.000 t. me përmbajtje 11,5% plumb, 10,5% zink dhe 8,5% kg.

Prodhimi në minierën e StanTërgut filloi më 1930, me kapacitet prej 500 tonelatash, i cili më 1932 u rrit në 2000 tonelata në ditë. Ndërkaq më 1938, prodhimtaria e xehes së plumbit dhe e zinkut arriti në 655.892 tonelata.

Krahas shtimit të prodhimit të xehes së plumbit dhe zinkut u rritën edhe kapacitetet e flotacionit në Trepçë. Kështu, më 1930 flotacioni punoi më 500t. xehe, më 1931 u ngrit në 1000 tonelata, më 1932 u ngrit në 397.963 t, më 1937 në 600.00 t, kurse më 1940 punoi 698.700 t. xehe.²

Në periudhën e viteve 1930 e deri më 20.04.1940 në Trepçë janë nxjerrë 6.100.271 tonelata xehe e përpunuar, 674.861 tonelata xehe e fisnikëruar dhe 488.908 tonelata koncentrat pirit³.

Në Kosovë hulumtimet dhe punimet rreth shfrytëzimit të xehes së kromit kanë filluar në vitin 1925, por deri më 1928 nuk kemi pasur ndonjë prodhim të rëndësishëm. Në periudhën e viteve 1928-1940 në Kosovë u prodhua gjithsej xehe kromi prej 149.890 tonësh. Në sasi të vogla xehja e kromit është prodhuar edhe në Brezovicë (Shtërpçë) dhe në Deve (Gjakovë)

Prodhimi i përgjithshëm i energjisë elektrike më 1939 ishte gjithsej 36.954.000 kilovat-orë, përkatësisht 58 KV-orë për një banor. Nga prodhimi i përgjithshëm i elektroenergjisë 92,8% prodhonte termoelektrana e xeherores Trepça.

Hulumtimet për thëngjill në Kosovë kanë zanafillën më 1920.

Prodhimi i thëngjillit në Kosovë ka filluar në vitin 1922 në minierën "Kosova" afër Obiliqit, përkatësisht Prishtinës. Në periudhën e viteve 1922-1940 në Kosovë janë prodhuar gjithsej 783.325 t. thëngjill.

² Dr. T. Avdyli: Zhvillimi i Industrisë në Kosovë, Enti i Historisë së Kosovës, Prishtinë, 1978 fq. 32.

³ Po aty fq. 34

2.2. Ndikimi i Minierave në Zhvillimin Ekonomik

Sektori minerar luan rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të vendit në tërësi. Synim i kësaj teme është vlerësimi dhe kuantifikimi i përfitimeve të krijuara nga industria minerare për ekonominë e vendit në tërësi, duke marrë parasysh pengesat, kufizimet teknike, zhvillimet në tregun ndërkombëtar të resurseve minerale, si dhe karakteristikat e vendburimeve minerale. Sektori i minierave paraqet mundësi për eksport dhe për përfitime të mëdha, e sidomos në rast të privatizimit të shpejt mund të përdoret për të përkrahur ngritjen e zhvillimit ekonomik në një afat të shkurtër. Në vitet e 90-ta industria është zvogëluar si rezultat i neglizhencës dhe mungesës së investimeve kapitale.

Investimi në sektorin e energjisë dhe minierave do të japë rezultate në një afat të mesëm (pesë deri në dhjetë vite), mirëpo edhe investimi në këtë sektor përfshin disa sfida:

- Investime të mëdha nevojiten për të ringjallur sektorin e minierave.
- Investimet nga jashtë janë të një rëndësie të veçantë.
- Duhet kushtuar një rëndësi të veçantë kushteve të nevojshme për tërheqje të investitorëve të jashtëm.

Me qëllim të rimëkëmbjes së këtij sektori me interes për zhvillimin ekonomik të vendit duhet të orientohen investimet kryesisht në këto drejtime.

- Infrastrukturën e minierës (kryesisht infrastrukturë, depo, banimi, zyre, menaxhimi i ujërave dhe hulumtimet afatgjate etj.),
- Pajisje (bartja e dheut, shfrytëzimi, bluarje, flotimi etj.) dhe
- Mjedisore (impiantet e trajtimit të ujit, deponitë e mbetjeve, monitorimi etj.)

Mbështetja e zhvillimit ekonomik kryesisht vetëm në minerale nuk është një strategji e mirë, sepse çmimet e artikujve të përdorimit të gjerë janë të paqëndrueshëm dhe në rastin e mineraleve trendi afatgjatë është në zvogëlim e sipër.

Një ngritje ose stimulim i shpejtë i zhvillimit ekonomik do të vijë nga procesi i privatizimit.

Privatizimi i ndërmartjeve shoqërorë do të ndihmojë në shpëtimin e bërthamave industriale që kanë një potencial të vërtetë ekonomik. Proces i privatizimit gjithashtu mund të ndikojë dhe ka për qëllim tërheqjen e investimeve direkte nga jashtë, jo vetëm për shkak të teknologjisë superiore dhe shkathtësive menaxhuese që vijnë me të, por edhe si shenjë e një ambienti të mirë të punës për investitorët e tjerë të interesuar.

2.3. Faktorët që ndikojnë në zhvillimin e minierave

Si në çdo organizatë tjetër, ashtu edhe në organizatat minerare ndikojnë një numër i madh i faktorëve të cilët në rastet më të shpeshta i grupojmë në faktorët e brendshëm dhe të jashtëm.

Faktorët e brendshëm kanë të bëjnë me kulturën dhe klimën organizative brenda organizatës (minierës). Këta faktorë ndikojnë në llojin e strukturës organizative, natyrën e organizatës të shprehur përmes filozofisë menaxheriale, objektivave dhe madhësisë së vet organizatës, teknologjisë dhe teknikave dhe ndikimin e tyre në kryerjen e punëve, natyrën dhe llojin e njerëzve të punësuar në organizata dhe nivelit në organizatë⁴. Ndërsa faktorët në mjedisin e jashtëm kanë të bëjnë më organizatën si sistem i hapur.

2.4. Faktorët e mjedisit të brendshëm

Në grupin e faktorëve në mjedisin e brendshëm⁵ bëjnë pjesë:

1. Njerëzit
2. Aktivitetet
3. Nivelet në organizatë
4. Natyra e organizatës
5. Struktura organizative
6. Teknologjia dhe metodat

Njerëzit, Faktori njeri është një ndër faktorët më të rëndësishëm që ndikon në zhvillimin e çdo organizate. Varësisht prej mënyrës së qasjes dhe ndikimit të njerëzve brenda organizatës mund të vjen deri te zhvillimi apo moszhvillimi i një organizatë. Faktori njeri ndikon në krijimin e kulturës dhe klimën organizative, apo në mënyrën se si gjërat bëhen në organizatë.

Aktivitetet, Renditja e aktiviteteve dhe menaxhimi i tyre në organizatë gjithashtu luan rol të rëndësishëm në zhvillimin e organizatës. Menaxhimi i keq dhe mosrenditja e aktiviteteve do të ndikonin negativisht në tërë procesin e punës brenda organizatës dhe si rezultat i kësaj do të vinte deri te mospërftimi i autputit të pritur.

Nivelet në organizatë, Definimi i qartë i niveleve udhëheqëse duke filluar nga ato më të ulëta e deri te nivelet më të larta, do t'i ndihmojë organizatës në renditjen dhe kryerjen me sukses të të gjitha aktiviteteve që dalin nga procesi i punëve. Me definimin (krijimin) e niveleve në organizatë do të jetë më lehtë të vijë edhe deri te identifikimi i shkaqeve dhe pasojave në rast të moskryerjes së ndonjë aktiviteti apo ngecjes së procesit të punës.

⁴ I. Kuka, J. Pula, B. Krasniqi, Menaxhmenti dhe Vendosja, Prishtinë, 2006, faqe 78

⁵ L. Mullins, Management and Organizational Behaviour, 7th edition, 2004.

Natyra e organizatës, Organizata varësisht prej natyrës së vet dhe llojit të veprimtarisë që ushtron mund të këtë ngecje apo zhvillim, për nga lloji i veprimtarisë mund të jenë organizata prodhuese, shërbyese, furnizuese apo edhe të kombinuara.

Struktura organizative, Pas definimit të natyrës dhe llojit të veprimtarisë organizata duhet të bëjë krijimin e strukturës organizative brenda ndërmarrjes, mbi bazën e kësaj strukture organizata do të krijojë edhe të gjitha nivelet udhëheqëse në organizatë.

Teknologjia dhe metodat, Në ditët e sotme organizata e mëdha të cilat synim të vetin kanë daljen në tregjet ndërkombëtare kujdes të veçantë janë duke i kushtuar ngritjes së kapaciteteve teknike dhe metodave të punës, si dhe ndikimin e tyre në kryerjen e punëve. Pra, zhvillimi i një organizate në ditët e sotme nuk mundë të paramendohet pa investim në teknologjinë informative dhe përdorimin e metodave efikase për punë të suksesshëm.

2.5. Faktorët e mjedisit të jashtëm

Si në çdo organizatë tjetër ashtu edhe në organizatat minerare ndikojnë një numër i caktuar i faktorëve⁶ në zhvillimin e këtyre organizatave.

1. Ekonomik
2. Teknologjik
3. Politik
4. Socialë dhe
5. Ndërkombëtarë

Faktorët ekonomikë kanë të bëjnë më natyrën dhe drejtimin e ekonomisë ku organizata zhvillon aktivitetin e saj⁷. Në kuadër të këtyre faktorëve do të veçojmë.

- Rritja e ekonomisë nënkupton madhësinë e kërkesës për mallra dhe shërbime, në këtë periudhë vije deri te zhvillimi i bizneseve dhe ulja e papunësisë.
- Interesi i ulët, konsumatorët të gatshëm për të marrë kredi.
- Inflacioni i lartë, ndërmarrjet fillojnë të paguajnë më shumë për materiale, shërbime e mirëmbajtje, paraja zhvlerësohet dhe kompanitë fillojnë të dobësohen.
- Papunësia do të ndikojë në nivelin e pagës që do të ofrojnë organizatat, në të kundërtën papunësia ulet, oferta do të pësojë rënie dhe punonjësit e kualifikuar do të kenë përparësinë që t'iu kërkojnë paga më të larta kompanive që janë të interesuar për ta.

Faktorët politikë në të shumtën e rasteve i gjejmë si faktorë politiko-ligjor. Këta faktorë përcaktojnë kuadrin, qeverinë dhe ligjet. Qeveria ndërhyr në jetën ekonomike, formon legjislacionin, nxjerr ligje sidomos në fushën e taksave dhe politikës fiskale, ushtron një

⁶ I. Kuka, J. Pula, B. Krasniqi, Menaxhmenti dhe Vendosja, Prishtinë, 2006, faqe 79

⁷ V. Kume, Menaxhimi Strategjik. Tiranë 2003, faqe 96

ndikim mjaft të madh jo vetëm në sferën e biznesit por edhe në aktivitete tjera të jetës shoqërore.

Shkalla e stabilitetit ekonomik të vendit luan rol të veçantë në zhvillimin e sektorit dhe është faktor vendimmarrës në tërheqjen e investitorëve jo vetëm të vendit por edhe të huaj. Gjithashtu në vendin tonë statusi i pazgjidhur deri më tani ka luajtur rol negativ në zhvillimin e minierave.

Faktorët teknologjikë nënkuptojnë pasqyrimin e njohurive aktuale të prodhimit, produkteve dhe shërbimeve. Impakti i teknologjisë reflektohet në produkte të reja, pajisje bashkëkohore dhe shërbime moderne. Përfitimet nga teknologjia janë të shumta ndikojnë në standardin jetësorë, më shumë kohë të lirë dhe intelektualë, alternativa të mundshme në produkte dhe shërbime.

Faktorët socialë kanë të bëjnë më zakonet, qëndrimet dhe sjelljet që janë karakteristikë e një grupi njerëzish apo edhe të një shoqërie të caktuar. Faktorët e këtij mjedisi ndikojnë në zhvillimin e një biznesi P.sh. dallohen zonat e njerëzve të arsimuar apo të paarsimuar, më standarde apo pa standarde, grup mosha etj.

Faktorët ndërkombëtarë, këta faktorë janë më rëndësi sidomos kur është fjala për kompanitë multinacionale. Në këtë grup hyjnë faktorët ekonomikë, politikë, socialë. ndërrimi i qeverisë, kursi i valutave, stabiliteti ekonomik, tregu etj.

3. KOMISIONI I PAVARUR PËR MINIERA DHE MINERALE

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale është themeluar më 21 janar 2005, në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2005/2. Deri në qershor të vitit 2008 ky institucion ka qenë fuqi e rezervuar e UNMIK-ut dhe ka pasur obligim t'i dorëzojë raporte vjetore PSSP-së. Në fillim të vitit 2007 KPMM është kosovarizuar tërësisht, mirëpo ka vazhduar prapë t'i raportojë PSSP-së.

Më 16 qershor të vitit 2008 është dekretuar Ligji Nr. 03/L-081 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2005/2 mbi Themelimin e Komisionit të Pavarur për Minierat dhe Minerale, dhe nga ajo datë KPMM i përgjigjet dhe i raporton Kuvendit të Republikës së Kosovës.

3.1. Funkcionet e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale rregullon dhe i mbikëqyrë:

- Eksplorimin dhe shfrytëzimin e rregullt të resurseve minerale në Kosovë;
- Shfrytëzimin optimal të resurseve minerale në të gjitha veprimet e shfrytëzimit të minierave dhe zvogëlimin e ndikimit të veprimeve të shfrytëzimit të minierave në mjedis;
- Zbatimin e standardeve ndërkombëtare për veprimet në miniera dhe në gurore;
- Sigurinë gjatë veprimeve të nxjerrjes së mineraleve dhe në objektet e përpunimit në pajtim më ligjin në fuqi dhe me standardet e nevojshme për sigurinë;
- Pajtueshmërinë e përgjithshme të veprimeve për shfrytëzimin e minierave me kushtet e licencave, marrëveshjeve për leje dhe të instrumenteve të tjera për autorizim.
- Komisioni i Pavarur për miniera dhe Minerale, është përgjegjës për kryerjen e funksioneve vijuese⁸:
- Lëshimin, bartjen, pezullimin dhe tërheqjen e lejeve dhe të licencave për eksplorim dhe shfrytëzim;
- Lëshimin, bartjen, pezullimin dhe tërheqjen e lejeve dhe të licencave lidhur me shfrytëzimin e lëndëve plasëse në veprimet për shfrytëzimin e minierave;
- Kryerjen e hetimeve lidhur me aksidentet që ndodhin në miniera dhe në gurore dhe veprimet e domosdoshme që nevojiten si pasojë e kësaj;
- Krijimin dhe mirëmbajtjen e bazës së të dhënave për titullarët e mineraleve dhe të drejtave për shfrytëzimin e minierave;

⁸ Ligji 03/L-081, Prishtinë, 2008

- Ofrimin e ndihmës teknike qeverisë për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me minierat dhe mineralet në Kosovë.

Komisioni i dorëzon raporte të rregullta Kuvendit të Republikës së Kosovës lidhur me të gjitha aktivitetet, duke përfshirë edhe çështjet e personelit të tij, organizimin dhe çështjet administrative.

Llojet e licencave dhe lejeve që jep Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale janë⁹:

- Licencën për hulumtim,
- Licencën për mbajtje e të drejtave,
- Licencën për shfrytëzim,
- Leje për ushtrimin e aktiviteteve të veçanta,
- Licenca për shfrytëzimin zejtar, dhe
- Licenca ose Leje në interes të publikut

Më poshtë është paraqitur në mënyrë tabelore numri i licencave të lëshuara nga viti 2005 deri në vitin 2010 si dhe është bërë krahasimi në formë¹⁰ grafike.

Tabela 1. Licencat/lejet e lëshuara nga KPMM sipas viteve dhe llojit të licencave/lejeve

Lloji i licencës/lejes	2005	2006	2007	2008	2009	2010	Gjithsejtë
Licenca të hulumtimit	10	13	27	74	53	73	250
Licenca të shfrytëzimit	33	49	54	38	26	27	227
Leje të posaçme	10	15	37	33	20	22	137
Gjithsejtë	53	77	118	145	99	122	614

⁹ Ligjit Nr. 03L-163

¹⁰ Raporti vjetor 2009-2010, KPMM




Figura 1. Licencat/lejeve e lëshuara sipas viteve

3.2. Organizimi i KPMM-së

Bordi - Komisioni përbëhet nga Bordi drejtues (Bordi), i cili i ka pesë anëtarë.

Të gjitha kompetencat e komisionit i ka¹¹ Bordi Qeverisës i KPMM-së. Çdo vendim i cili kërkohet të merret nga KPMM duhet të merret nga vetë Bordi i KPMM, sipas ligjit të minierave dhe mineraleve.

Kryesuesi udhëheq dhe organizon punën e Bordit të KPMM-së. Kryesuesi thërret mbledhjet e Bordit të KPMM-së kur e sheh të domosdoshme ose kur kërkohet nga dy (2) anëtarë tjerë të Bordit të KPMM-së.

Kuorumi për mbledhjet e Bordit të KPMM-së është tre (3) anëtarë.

Kryesuesi kryeson mbledhjet e Bordit të KPMM-së. Në raste të jashtëzakonshme kur është e domosdoshme për Bordin e KPMM-së të takohet në mungesë të Kryesuesit, Kryesuesi autorizon një nga anëtarët tjerë të Bordit të KPMM-së të kryesojë mbledhjen.

Për çdo vendim të Bordit të KPMM-së kërkohet vota afirmative e të paktën tre (3) anëtarëve të Bordit.

Për marrjen e një vendimi në bord, Drejtori dhe stafi tjetër profesional përgatisin dhe shqyrtojnë kërkesat veç e veç sipas departamenteve, pastaj përmes takimeve të para-bordit bëhet seleksionimi i kërkesave që plotësojnë kriteret për t'u përcjellë për bord, në përputhje me ligjet në fuqi.

Drejtori - Drejtori emërohet nga Bordi i KPMM-së në bazë të rezultateve të një konkurrimi të hapur dhe transparent të kryer në bazë të kriterëve objektive. Drejtori i KPMM është përgjegjës për ushtrimin e të gjitha funksioneve të deleguara nga Bordi i

¹¹ Ligjit NR. 03/1-163 Ligji për Miniera dhe Minerale - Neni 59, Fq 50

KPMM-së; udhëheqjen e punës së zakonshme të KPMM-së në pajtim me vendimet dhe udhëzimet e lëshuara nga Bordi i KPMM-së dhe në përputhje me legjislacionin përkatës; përgatitjen e mbledhjeve të Bordit dhe sigurimin e zbatimit të duhur të vendimeve të marra nga Bordi. Gjatë mungesës së Drejtorit ose gjatë cilësdo periudhë kohore gjatë të cilës Drejtori nuk është në gjendje që të kryejë detyrat e tij, Bordi mund t’ia caktojë këto detyra një zyrtari të lartë të KPMM¹².

Në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale, për vitin 2011 janë të aprovuara 79 pozicione për staf.

Në kuadër të KPMM-së funksionojnë këto Departamente dhe Njësi:

- Departamenti i Inspektoratit,
- Departamenti i Gjeologjisë,
- Departamenti i Administratës
- Departamenti i Financave,
- Departamenti i Gjeodezisë,
- Departamenti i GIS-it,
- Departamenti Ligjor
- Departamenti i Prokurimit,
- Departamenti i Teknologjisë Informative, dhe
- Njësia e Auditimit të Brendshëm.

3.3. Hyrjet dhe Shpenzimet e KPMM-së nga viti 2006 deri në vitin 2010

Që nga viti 2006 e deri në vitin 2010, kur Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale ka filluar të inkasojë të hyra, krahasuar me buxhetin¹³ e shpenzuar KPMM ka qenë edhe kontribues neto në Buxhetin e Konsoliduar të Republikës së Kosovës. Shumë më qartë kjo mund të shihet në tabelën dhe grafikun e paraqitur më poshtë:

Tabela 2. Krahasimi i të hyrave dhe Shpenzimeve në vitet 2006-2010

Nr. Rendor	Vitet	Të hyrat	Shpenzimet	Ndryshimi
1	Viti 2006	2,627,553.00 €	1,730,909.46 €	896,643.54 €
2	Viti 2007	2,029,092.00 €	1,777,005.03 €	252,086.97 €
3	Viti 2008	5,021,596.00 €	784,640.47 €	4,236,955.53 €

¹² Ligjit NR. 03/1-163 Ligji për Miniera dhe Minerale - Neni 63, Fq 54

¹³ Raportet Financiare të KPMM-ës 2006-2010

4	Viti 2009	4,459,755.00 €	1,469,765.93 €	2,989,989.07 €
5	Viti 2010	8,460,537.24 €	1,398,602.00 €	7,061,935.24 €
Total		22,598,533.24 €	7,160,922.89 €	15,437,610.35 €




Figura 2. Krahasimi i të hyrave dhe Shpenzimeve në vitet 2006-2010

4. Roli i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale dhe Implementimi i projekteve të Financuara nga KPMM

Duke pasur parasysh se në Kosovë ende nuk është themeluar Shërbimi Gjeologjik i Kosovës, i cili do të ishte përgjegjës për të gjitha hulumtimet që janë kryer në të kaluarën dhe përgjegjës për kryerjen e hulumtimeve të reja, këtë funksion është duke e kryer Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale. Ky komision posedon Arkivin Gjeologjik të Kosovës, si dhe ka krijuar edhe GIS-in, apo Gjeodatabazen e Kosovës, me anë të së cilës ka përgatitur shumë projekte që do t'i ndihmojnë në menaxhimin e resurseve minerare. Këto të dhëna mund të shërbejnë si bazë e mirë edhe për investitorët e interesuar, që të mund të fillojnë përgatitjen e projekteve të tyre të hulumtimit dhe të shfrytëzimit.

Pikat kryesore që përmban Gjeodatabaza e Kosovës, e cila është përgatitur në KPMM, janë:

Digjitalizimi i hartave¹⁴

- Harta Gjeologjike me shkallë 1:100,000;
- Harta Gjeologjike me shkallë 1:200,000;
- Harta Hidrogjeologjike me shkallë 1:200,000;
- Harta Tektonike me shkallë 1:200,000;
- Harta Mineralogjike me shkallë 1:200,000;
- Harta Termominerale me shkallë 1:200,000;
- Harta Pedologjike me shkallë 1:200,000;

Databaza¹⁵

- Moduli Aplikacionet dhe licencat;
- Moduli Depozitimet dhe rrjedhjet;
- Moduli Dokumentet;
- Moduli Fabrikat për Përpunim;
- Moduli Lejet për shpërthim (Minim);
- Moduli Lokacionet e kontaminuara;
- Moduli Mostrat dhe Analizat;
- Moduli Ngastrat (parcelat);

¹⁴ Raporti vjetor 2007, KPMM

¹⁵ Raporti vjetor 2006, KPMM

- Moduli Personat dhe Kompanitë;
- Moduli Plani i Guroreve të Kosovës;
- Moduli Punë Fushore Gjeologjike;
- Moduli Regjistrimi i Eksplozivëve;
- Moduli Vendshfrytëzimet;
- Moduli Shpimet;

Përveç përdorimit të këtyre hartave dhe moduleve nga ana e KPMM-së dhe institucioneve të tjera, ato mund të përdoren edhe nga investitorët, si bazë fillestare shumë e mirë për të filluar me përgatitjen e një projekti investiv në industrinë minerare.

Më poshtë mund të shihet interfejsi i Gjeodatabazes së Kosovës (GDK).




Figura 3. GDK Gjeodatabaza e Kosovës¹⁶

Në figurën më lart është paraqitur Gjeodatabaza e Kosovës, me modulet përbërëse të cilat përmbajnë informata të ndryshme që i shërbejnë komisionit për menaxhim të resurseve minerare, si dhe kompanive për përgatitjen e projekteve të tyre për të investuar në industrinë minerare në Kosovë.

¹⁶ Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, 2007

4.1. Matjet Ajrore Gjeofizike

Matjet Ajrore Gjeofizike¹⁷ po ashtu është një projekt shumë i rëndësishëm i përfunduar nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, që është zhvilluar gjatë vitit 2006/2007, dhe është implementuar nga Shërbimi Gjeologjik i Britanisë së Madhe bashkë me Shërbimin Gjeologjik Finlandez. Me anë të këtij projekti është bërë identifikimi i zonave ku janë të koncentruar mineralet e ndryshme. Më poshtë mund të shihet harta e Kosovës me disa nga rezultatet e këtij fluturimi.




Figura 4. Harta me intensitet magnetik nga Matjet Ajrore Gjeofizike¹⁸

Kompanitë e interesuara, duke i shfrytëzuar këto të dhëna, mund ta kenë një bazë shumë të qartë për të vazhduar më hulumtimet e tjera. Këto rezultate po ashtu kanë një ndikim shumë të madh në sigurinë e investimeve të huaja, sepse shkalla e rrezikshmërisë së dështimit të investimeve është shumë më e vogël nëse këto rezultate merren parasysh.

¹⁷ Raporti vjetor 2006/7, KPMM

¹⁸ Shërbimi Gjeologjik Finlandez & Shërbimi Gjeologjik Britanik, Projekti “Matjet Ajrore Gjeofizike” 2007, KPMM

4.2. Përpyllimi i Plansheteve të Hartës Gjeologjike të Kosovës

Rilevimi gjeologjik në shkallë 1 : 25 000 ka përfshi rajonin Volljakë – Kramovik. Rajoni i rilevuar paraqet një nyje të rëndësishme në gjeologjinë e Kosovës dhe më gjerë. Në aspektin shkencor në këtë rajon janë evidentuar fakte të terrenit me rëndësi thelbësore për trajtimet paleogeografike dhe paleotektonike të brezit Dinarido – Albanido – Helenid.

Gjatë rilevimit gjeologjik janë sqaruar në mënyrë të kënaqshme shumica e problemeve gjeologjike të rajonit. Janë trajtuar probleme të stratigrafisë, tektonikës, magmatizmit e resurseve minerale dhe janë përpiluar hartat gjeologjike, strukturore dhe të mineraleve të dobishme për të dy planshetet e përfshira në studim. Projekti i Plansheteve të Hartës Gjeologjike të Kosovës është projekt i cili ka filluar të realizohet që nga viti 2009, 2010 dhe po ashtu ky projekt është i aprovuar në buxhet të vitit 2011, pra projekt që do të vazhdojë edhe në të ardhmen¹⁹.

KPMM planifikon që të vazhdojë më projektin e rilevimit të tërë territorit të Kosovës në shkallë 1: 25 000.



Figura 5. Harta e resurseve minerale të Kosovës – plansheti i Volljakut si rezultat i rilevimit 1:25000

¹⁹ Raporti vjetor 2009, KPMM

5. ROLI I INSTITUCIONEVE TJERA NË ZHVILLIMIN E INDUSTRIË MINERALE NË KOSOVË

Në zhvillimin e industrinë minerare në Kosovë, ndikojnë edhe institucionet e tjera përveç Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale. Ndikim në zhvillimin e sektorit minerar kanë Ministria e Energjisë dhe Minerave, Ministria për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Komunitat, si dhe Parlamenti i Kosovës.

5.1. Ministria e Energjisë dhe Minerave

Në bashkëpunim të ngushtë me Qeverinë e Republikës së Kosovës, zhvillon politika, përgatit dhe zbaton ligje për zhvillimin e sektorit të energjetikës dhe minierave²⁰, veçanërisht me qëllim të arritjes së bashkimit më të mirë të mundshëm të vlerave ekonomike, shoqërore dhe të mjedisit.

Përkrah një mjedis të favorshëm për investuesit në zhvillimin e sektorit të energjetikës dhe minierave dhe bashkëpunon ngushtë me Ministrinë e Ekonomisë dhe të Financave, Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe organet përkatëse rregullatore për të përcaktuar kushtet e përgjithshme për investime, veçmas duke pasur parasysh stimulimet fiskale, duke përfshirë tatimet, fitimet dhe çështjet e qiradhënies në lidhje me sektorin e energjetikës dhe të minierave.

Në bashkëpunim me organet dhe institucionet përkatëse në mënyrë sistematike bën mbledhjen, arkivimin, kompilimin, përpunimin si dhe i vë në dispozicion të dhënat gjeoshkencore përkitazi me resurset gjeologjike të Kosovës dhe me kërkesë të Qeverisë i siguron raportet që i ka në dispozicion dhe vlerësimet e ekspertëve lidhur me çështjet gjeoshkencore.

Promovon teknologji dhe programe efikase energjetike, përdorimin e arsyeshëm të energjisë dhe të resurseve minerare dhe promovon burimet e ripërtëritshme të energjisë.

Përkrah inspektoratet përkatëse në sektorin e energjetikës dhe të minierave në zbatimin e funksioneve dhe përgjegjësi të tyre që u janë caktuar me ligj.

Mbikëqyrë lëshimin e licencave dhe lejeve për veprimtarinë e minierave në Kosovë nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale. Ministria mund t'i bëjë rekomandime Kuvendit të Republikës së Kosovës nëse ajo mendon se ndonjë vendim i rregullatorit të pavarur për miniera nuk është në përputhje me politikat e miratuara për sektorin e minierave apo me ligjin në fuqi.

Merr informata prej Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale lidhur me lëshimin e licencave dhe të lejeve për veprimtarinë e sektorit minerar në Kosovë. Qeveria mund të kërkojë sqarime plotësuese lidhur me këto licenca dhe leje.

Përkrah dhe promovon zhvillimin e resurseve njerëzore me aftësi të larta dhe profesionale në sektorin e energjetikës dhe të minierave.

²⁰ Rregullorja 2005/15, pjesa XIII, 2005

Merr pjesë në zhvillimin e fushatave për informim publik dhe të projekteve të tjera promovuese për të rritur vetëdijesimin publik dhe reagimin ndaj çështjeve përkitazi me sektorin e energjetikës dhe të minierave. Rregullorja 2005/3, neni 17.1, parasheh që mineralet dhe zonat të procedohen përmes tenderit konkurrues, gjë që i jep Ministrisë së Energjisë dhe Minierave një rol kyç në caktimin e zonave të interesit dhe në caktimin e kriterëve për zbatimin e ndonjë projekti të caktuar.

Po ashtu, për mineralet energjetike ministria ka një rol kyç në caktimin e kushteve të projektit dhe kriterëve që duhet të përmbushen.

5.2. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Ndërmarrjet minerare për të marrë një licencë për shfrytëzim të mineraleve, përveç tjerash janë të obliguara që ta përgatisin një projekt për Rikultivimin e zonës së shfrytëzimit dhe të marrin një Pëlqim Ambiental nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor²¹.

Roli i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) këtu është i madh, sepse cakton kriteret për përgatitjen e projekteve të rikultivimit, si dhe kriteret për mbrojtje të ambientit. Po ashtu, cakton edhe zonat e mbrojtura për operime minerare, siç janë parqet nacionale dhe zona të tjera të mbrojtura.

Duke caktuar kriteret e rikultivimit dhe të mbrojtjes së ambientit, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka ndikim direkt në menaxhimin e resurseve minerare. Kompania është e obliguar që projektin e saj t'ia përshtatë kriterëve të caktuara nga MMPH-ja. Mirëpo, nëse gjatë implementimit nuk i përmbahet projektit të pranuar, atëherë MMPH-ja mund ta revokojë Pëlqimin e dhënë dhe më këtë i rekomandon Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për pezullim të licencës së shfrytëzimit. Pezullimi i licencës ka ndikim shumë të madh negativ financiar në projektin e ndërmarrjes.

Është shumë e rëndësishme që MMPH-ja t'i caktojë paraprakisht kriteret e përgatitjes së projekteve të rikultivimit, si dhe t'i caktojë zonat e mbrojtura nacionale. Nëse këto bëhen pasi që ndërmarrjet minerale të kenë filluar implementimet e projekteve të tyre, kjo ka shumë ndikim negativ në investimet në këto projekte, si dhe ka ndikim negativ në investimet e reja në këtë sektor.

Shembull i caktimit me vonesë të zonave të mbrojtura kemi zonën e Gadimes,²² ku Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor më 12.12.2005 ka nxjerrë një vendim me të cilin shpall zonë të mbrojtur 3 km nga shpella e Gadimes. Në kohën e shpalljes së këtij vendimi në këtë zonë ishin 4 ndërmarrje për eksploatimin dhe përpunimin e gurit, si dhe një depo për deponimin e eksploziveve komerciale.

Siç dihet, investimet për një operim në sektorin minerar janë shumë të mëdha dhe në këtë rast janë rrezikuar qindra mijëra euro investime, e po ashtu rrezikohen edhe vendet e

²¹ Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Rregullorja 2003/9, 2003

²² Vendimi Nr. 27/05, Ndalimi i operimeve minerare rreth shpellës së Gadimes, MMPH, 2005

punës të më se 100 punëtorëve. Për këtë, është shumë më rëndësi që të kemi politika të qarta të MMPH-së në këtë lëmi para përgatitjes së projekteve në lëmin e minierave.

5.3. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Duke pasur parasysh se kjo ministri merret me menaxhimin e tokave bujqësore dhe të pyjeve të shtetit, edhe kjo ministri luan rolin e vet në menaxhimin e sektorit minerar. Për t'u pajisur me licencë të shfrytëzimit për operim në sektorin e minierave, nëse toka është nën menaxhimin e kësaj ministrie, gjegjësisht Agjencionit Pyjor të Kosovës, ndërmarrja duhet të përgatisë projektin e ripyllëzimit dhe të marrë pëlqimin nga Agjencioni Pyjor për të operuar në atë zonë. Agjencioni Pyjor cakton kriteret e ripyllëzimit, ndërsa projektanti është i obliguar t'u përmbahet këtyre kriterëve gjatë përgatitjes së projektit dhe implementimit të tij²³.

5.4. Komunat

Edhe pse rregullorja 2005/3 i ka zhveshur komunat nga shumë kompetenca, në këtë rast për menaxhimin e resurseve minerare prapëseprapë roli i komunës është i madh. Asnjë projekt minerar nuk pranohet nga ana e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale pa e pasur pëlqimin komunal paraprak. Duke i caktuar planet urbanistike, komuna luan rol të madh në vendimin e kompanisë se ku të përcaktohet për të bërë projektin investiv²⁴.

5.5. Parlamenti i Kosovës

Duke pasur parasysh se parlamenti është organi më i lartë legjislativ i një vendi, atëherë gjithsesi roli i tij në menaxhimin e resurseve minerare është i madh. Në Kosovë parlamenti luan rol indirekt duke aprovuar politikat dhe strategjinë e minierave të propozuar nga MEM-i, si dhe duke aprovuar planet urbanistike dhe zonat e mbrojtura të propozuara nga MMPH-ja. Duke pasur parasysh se gjatë përgatitjes së projekteve të tyre investive në miniera kompanitë janë të obliguara që t'u përmbahen këtyre politikave dhe strategjive, mund të themi se ky është roli indirekt i parlamentit në zhvillimin e sektorit të minierave.

²³ Ligji për Pyjet e Kosovës 2003/3, Kuvendi i Kosovës, 2003

²⁴ Rregullorja mbi Vetëqeverisjen e Komunave në Kosovë, 2000/45, UNMIK, 2000

6. RENTA MINERARE (TANTIEMA)

Në praktikat ndërkombëtare, renta minerare caktohet me përqindje për ato minerale të cilat janë të radhitura në tregjet botërore të bursave. Çmimi i tantimës ndryshon varësisht nga çmimi në bursa, ndërsa në shumica fikse caktohet zakonisht për ato minerale të cilat nuk gjenden në bursa, e për të cilat duhet të merren çmimet nga tregu i zakonshëm. Për shkak të vështirësive në përcjelljen e përditshme të çmimeve, si dhe për shkak të ndryshimeve të çmimit nga tregu në treg, atëherë renta minerare caktohet fikse.

Shkalla e rentës minerare ndryshon nga vendi në vend. Kemi shtete, siç janë Suedia dhe Mali, të cilat e kanë zero shkallën e rentës minerare, e deri tek ato që shkallën e rentës minerare e kanë 10 % në shkallën e shitjes, për shembull Botsvana për diamant.

Përqindja nënkupton përqindjen e çmimit shitës në bursat e caktuara për secilin mineral.

Më poshtë është paraqitur në formë tabelore dhe grafike krahasimi i rentës minerare në Kosovë dhe mesataren e disa shteteve në botë.

Tabela 3. Mesatarja e tantimës në Kosovë dhe në vendet e tjera

Emri i Shtetit	Përqindja mesatare e Rentës minerare
Afganistani	7.50%
Uruguay	5.80%
Burkina Faso	5.70%
Botsëana	5.20%
Nigeria	5.00%
Ghana	4.50%
South Africa	4.50%
Turkey	3.10%
Mexico	3.00%
Peru	3.00%
Mauritania	2.80%
Papua Neë Guinea	2.00%
Kosova	2.00%
Philippines	1.00%
USA	0.80%
Zambia	0.60%
Mali	0.00%
Sëeden	0.00%




Figura 7. Mesatarja e rentës minerare në Kosovë dhe në vendet tjera

Nga paraqitja tabelore dhe grafike e krahasimit të rentës minerare në Kosovë dhe në vendet e tjera mund të vërehet se shkalla e rentës minerare aktuale në Kosovë për mineralet kryesore është dukshëm më e ultë së në shumicën e shteteve në botë.

6.1. Kriteret për caktimin e rentës minerare

Kriteret për caktimin e rentës minerare dallojnë nga vendi në vend. Në disa vende bëhet zbritja e shpenzimeve të amortizimit, zbritja e shpenzimeve të transportit nga miniera deri te porti shitës; në disa vende xehja llogaritet në gjendje natyrore, e në disa vende si xehe e terur. Mirëpo, kriter i përbashkët për të gjitha vendet është se baza për llogaritje gjithëherë merret nga sasia e nxjerrë dhe nga çmimi shitës në treg.

Kriteret kryesore për caktimin e shkallës së rentës minerare janë:

- Ndikimi i vendit në tregjet botërore të mineralit të caktuar;
- Kushtet e nxjerrjes së mineralit;
- Shpenzimet për nxjerrjen e mineralit;
- Çmimet e transportit nga miniera deri te porti;
- Çmimet në treg të mineraleve;
- Niveli i kërkesës dhe ofertës në treg për llojin e mineralit;
- Politikat e shtetit për stimulimin e nxjerrjes së një minerali të caktuar;
- Politikat e shtetit për mbrojtjen e një minerali të caktuar;
- Sasia e mineralit të caktuar që posedon vendi;

- Politikat e shtetit për të nxitur përpunimin e një minerali të caktuar në vend;
- Shkalla e ndotjes së ambientit me nxjerrjen e një minerali të caktuar etj.

Edhe në Kosovë, në Udhëzimin e nxjerrë nga Autoriteti Qendror Fiskal në vitin 2001, janë zbritur shpenzimet e amortizimit dhe shpenzimet e transportit.

Ndërsa tani, në udhëzimin e ri janë bërë disa ndryshime, siç janë: xehja llogaritet në xehen natyrore, nuk zbritet asnjë shpenzim, mirëpo ka zbritje për mineralet që përpunohen brenda vendit, në 20 % nëse shkrihen dhe 50 % nëse përpunohen pas shkrirjes²⁵.

Sa i përket aprovimit të shkallës së rentës minerare, në bazë të Ligjit të minierave dhe mineraleve (Ligji Nr. 03L-163, neni 50), Ministria për Energji dhe Miniera dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave, pas konsultimit dhe marrjes së pikëpamjeve të KPMM-së dhe palëve tjera të interesuara, duke përfshirë bartësit ekzistues të licencave ose përfaqësuesit e tyre, bashkërisht përgatisin dhe nxjerrin një propozim listë të rentës minerare. Pasi që lista të jetë përgatitur nga të dy ministrinë përkatëse, ata bashkërisht ia dorëzojnë listën e propozuar Qeverisë për miratimin e saj. Pas miratimit, Qeveria ia dorëzon listën Kuvendit të Republikës së Kosovës për miratim.

6.2. Caktimi i rentës minerare

Në Kosovë renta minerare aplikohet që nga vitet e pasluftës. Lista e rentës minerare është hartuar për herë të parë në vitin 2001, apo më mirë të thuhet është huazuar modeli australian i llogaritjes së taniemës, grupizimi i mineraleve dhe caktimi i lartësisë së rentës minerare²⁶. Përjashtim nga modeli australian në lartësinë e rentës minerare është bërë për mineralet ndërtimore, duke e caktuar një çmim më të lartë për to, sepse çmimi në tregun e Kosovës për mineralet ndërtimore në atë kohë ka qenë shumë i lartë.

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur lista e mineraleve dhe lartësia e rentës minerare e caktuar për ato minerale. Në vitin 2001, kur është nxjerrë kjo listë, në Kosovë valuta zyrtare ka qenë marka gjermane.

Ky Udhëzim është nxjerrë më 12 korrik 2001, nga Autoriteti Qendror Fiskal dhe Departamenti për Qeverisje Lokale. Në të ka qenë karakteristike se të hyrat nga renta minerare janë mbledhur nga inspektorët komunalë, ndërsa është bërë ndarja e tyre në 50 % për nevojat e komunës dhe 50 % për nevojat e buxhetit qendror.

Disa nga mineralet i kam paraqitur në tabelën më poshtë, ndërsa tabela e përgjithshme është e paraqitur në Aneksin 1.

²⁵ Udhëzim Administrativ për Tantiema, Ministria e Energjisë dhe Minierave, (Republika e Kosovës, 2008)

²⁶ "CFA Administrative Instruction No. 2001/2", Autoriteti Qendror Fiskal dhe Departamenti për Qeverisje Lokale, (Prishtinë, 2001).

Tabela 4. Lista e rentës minerare e aplikuar në Kosovë nga 2001-2007²⁷

Minerali	Tantiema	Specific gravity	Renta minerare	Njësia	Vërejtje
Barytes	DM 0.40		€ 0.20	t	
Bauxite	DM 0.30		€ 0.15	t	
Bentonite	DM 0.60		€ 0.31	t	
Brick clay	DM 0.30		€ 0.15	t	
Calcite	DM 0.30		€ 0.15	t	
Chromite	2% ex-miNë value (value less alloëable deductions)				
Coal (Bituminous)	DM 1.50		€ 0.77	t	
Coal (Linjite)	DM 0.50		€ 0.26	t	
Diamond	2% ex-miNë value (value less alloëable deductions)				
Gold	2% ex-miNë value (value less alloëable deductions)				
Graphite	2% ex-miNë value (value less alloëable deductions)		€ 0,00		
Gypsum	DM 0.30		€ 0.15	t	
Iron	DM 0.30		€ 0.15	t	
Lead	2% ex-miNë value (value less alloëable deductions)				
Limestone	DM 2.00		€ 1.02	m ³	DM 1.00 për tonNë or DM 2.00 për cubic metre
Nickel	2% ex-miNë value (value less alloëable deductions)				
Sand & Gravel	DM 5.00		€ 2.56	m ³	DM 5.00 për cubic metre
Silver	2% ex-miNë value (value less alloëable deductions)				

Me Rregulloren e UNMIK-ut 2005/3, tantimën ka qenë i obliguar që ta caktojë Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, në konsultim me Ministrinë për Ekonomi dhe Financa²⁸. Në vitin 2005 është adaptuar çmimorja nga viti 2001, ndërsa në nëntor të vitit 2006, Bordi Qeverisës i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale ka marrë

²⁷ "CFA Administrative Instruction No. 2001/2", Autoriteti Qendror Fiskal dhe Departamenti për Qeverisje Lokale, (Prishtinë, 12 Korrik 2001).

²⁸ Rregullorja e UNMIK-ut 2005/3, neni 58, 2005.

vendim për rishikimin e tarifës. Një grup punues (në atë grup kam marrë pjesë edhe unë si kryesues i Departamentit të Financave), ka përgatitur një tarifë të re, e cila i është rekomanduar Bordit të KPMM-së, dhe pas aprovimit nga Bordi, kjo tarifë ka hyrë në fuqi që nga janari i vitit 2007.

Tarifa e re është ndryshuar për mineralet industriale, ndërtimore, gurë të çmuar dhe ujë mineral & termal, ndërsa nuk është ndryshuar për mineralet metalike dhe mineralet energjetike. Ndryshimi i rentës minerare për këto minerale është shtyrë me qëllim që ky propozim të rishikohet edhe njëherë nga qeveria dhe parlamenti, sepse shfrytëzimi i këtyre mineraleve në zhvillimin ekonomik të Kosovës ka një rëndësi të veçantë. Është shumë me rëndësi që kjo tarifë të përputhet me politikat e qeverisë për zhvillimin e minierave, politika të cilat duhet të jenë të aprovuara nga Kuvendi i Kosovës.

Edhe pse në bazë të Rregullores 2005/3, mandatin për aprovimin e çmimoreve e ka pas Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, megjithatë Komisioni ka marrë vendim për rishikim të këtyre tarifave në bashkëpunim me Qeverinë dhe Parlamentin. Kjo për shkak se është e domosdoshme që në Kosovë të ketë stabilitet dhe pajtueshmëri në mes të institucioneve, meqë investitorët e huaj janë shumë të interesuar të ketë stabilitet ligjor në një vend para se të marrin vendim për investimin e parave të tyre. Nëse do të kishim mospajtime në mes të institucioneve në lidhje me lartësinë e tantimës, kjo do të krijonte dyshime tek investitorët potencialë se pas bartjes së kompetencave nga ndërkombëtarët te vendorët, apo pas ndërrimit të partive politike në pushtet, mund të ndodhin ndryshime të mëdha të cilat do t'i rrezikonin investimet e tyre.

Tash me ligjin e Minierave dhe Mineraleve (Ligji Nr. 03/L-163), rentën minerare e propozon Ministria e Energjisë dhe Minierave, Ministria e Ekonomisë dhe Financave, në konsultim me Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale dhe përfaqësuesit e kompanive të cilët janë bartës të licencave. Ky propozim dërgohet në Qeveri për miratim, ndërsa Kuvendi i Republikës së Kosovës e miraton listën e rentës minerare.

Në tarifën e aprovuar nga Bordi Qeverisë i KPMM-së për Mineralet Ndërtimore dhe Industriale vërehet se kemi një ulje 50 % të tarifave të tantimës. Kjo është bërë me qëllim të stimulimit të rritjes së investimeve në këtë sektor, si dhe për shkak të ndërrimit të çmimit të tregut për shitjen e këtyre mineraleve. Një pjesë e tarifave të reja për mineralet ndërtimore dhe industriale në Kosovë mund të shihen në tabelën e mëposhtme, ndërsa tabela e kompletuar gjendet në Aneksin 2.

Tabela 5. Renta minerare për mineralet ndërtimore, industriale, gurë të çmuar dhe ujë mineral & termal²⁹.

Tantiema për shfrytëzimin e mineraleve (TSHM)							
N r.	Grupi lëndës minerale	Nëngrupi i lëndës minerale/	Lënda minerale	Njësia	Tantiema		V ë r e j t j e
			Shqip	(t,m ³)	%	(€)	
1	2	3	4	5	6	7	
1	Mineralet industriale/ <i>Industrial Minerals</i>	Argjilat/ Clay / Glina	Argjilë qeramike	t		€ 0.20	
			Argjilë zjarrduruese	t		€ 0.20	
			Argjilë për tulla	t		0.13 €	
			Rëra kuarcore	t	4.00%		
		Mineralet zjarrduruese dhe për qeramikë	Asbesti	t	4.00%		
			Bentoniti	t		0.60 €	
			Dunit-industri	m ³		0.60 €	
			Haloizit	t		1.20 €	
			Kaolin	t	4.00%	0.53 €	
2	Minerale ndërtimore/ <i>Construction</i>	Me minim/ Ëith <i>blasting/ Sa Miniranjem</i>	Andezit	m ³		0.50 €	
			Bazalt	m ³		0.60 €	

²⁹ KPMM, Prishtinë, 2007

<i>Minerals</i>	Materiale të pa lidhura dhe inert/Unlinked and loose materials/ Nepovezani slobodan materijal	Depozitime deliviale	m³		1.00 €	
		Rërë dhe zhavorr (në lum)	m³		1.25 €	

Ndryshimi i rentës minerare për mineralet metalike dhe energjetike është ende në proces e sipër. Rekomandimet e para të ekspertëve vendorë janë që të bëhet dyfishimi i rentës minerare për këto minerale, duke pasur parasysh edhe çmimet e larta të metaleve në bursa. Mirëpo, ende kemi një vonesë në këtë drejtim, sepse domosdoshmërisht renta minerare duhet të përshtatet me Strategjinë e Zhvillimit të Minierave, e cila duhet të përgatitet nga qeveria dhe të aprovohet nga kuvendi. Me këtë strategji do të vendoset nëse do të bëhet stimulimi i nxjerrjes së ndonjë minerali të caktuar dhe nëse do të bëhet stimulimi i përpunimit të xeheve në vend etj.

Mirëpo, edhe nëse nuk arrihet që Strategjia për Zhvillimin e Minierave të finalizohet dhe të aprovohet në vitin 2011, është e domosdoshme që çmimi i rentës minerare të ndryshohet. Kjo duhet të bëhet për shkak se çmimet e metaleve aktualisht janë të larta, ndërsa edhe aktivizimi i minierave në Kosovë është rritur nga viti 2007, kur Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale i ka lëshuar licencë për prodhim Ferronikelit në dy miniera dhe ish-minierave të Trepçës në Stanterg, Artanë, Cernac dhe Belloberdo. Po ashtu ka në përgatitje e sipër edhe minierat e Goleshit, Xim Strezovcit, Drazhnjes etj.

Prandaj, duhet shfrytëzuar këto çmime të larta të metaleve që edhe Buxheti Republikës së Kosovës të përfitojë nga nxjerrja e xeheve në Kosovë.

Është e rëndësishme të përmendet së rishikimi i rentës minerare do të këtë një llogaritje të re dhe më të thjeshtë, pasi në të gjitha mineralet që janë në bursë do të këtë një llogaritje sipas përqindjes.

Përqindja në llogaritjen e rentës minerare nënkupton përqindjen e caktuar që llogaritet nga çmimi në bursë i atij minerali, pra inkasimi i përqindjes bëhet në bruto, sasia e prodhuar shumëzuar me çmimin shitës shumëzuar me përqindjen e caktuar.

6.3. Ndikimi i Rentës Minerare në Buxhetin e Kosovës

Ndikimi i rentës minerare në buxhetin e Republikës së Kosovës. Në vitin 2007, në emër të Rentës minerare janë mbledhur³⁰ rreth 2.5 milionë euro; në vitin 2008 ka shënuar një ngritje të dukshme dhe janë mbledh³¹ mbi 5 milionë euro; ndërsa në vitin³² 2009, në

³⁰ Raporti Vjetor i KPMM-së për vitin 2007

³¹ Raporti Vjetor i KPMM-së për vitin 2008

³² Raporti Vjetor i KPMM-së për vitin 2009

raport më vitin 2008 kemi pas një renje të hyrave, ku janë mbledh rreth 4.5 milion euro. Inkasimi i të hyrave në vitin 2010³³ ka shënuar një rritje rreth 8.5 milion euro.

Në tabelën e mëposhtme mund të vërehet së edhe përqindja e grumbullimit të rentës minerare nga grupet e mineraleve ka ndryshuar dukshëm.

Tabela 6. Renta minerare e paguar në përqindje sipas grupeve të mineraleve në vitet 2007-2010

Nr	Përshkrimi	2007	2008	2009	2010
1	Minerale Metalike	-	20 %	30.50 %	41 %
2	Minerale Energjetike	61.03 %	57.3 %	36.71 %	23.5 %
3	Minerale Ndërtimore	31.97 %	17.7 %	28.53 %	32.7 %
4	Taksa Administrative	7 %	5 %	4.25 %	2.8 %
Totali		100%	100%	100%	100%

Ndikimi i rentës minerare në krijimin e të hyrave për buxhetin e Republikës së Kosovës është në rritje e sipër. Duke pasur parasysh se mbledhja e rentës minerare është bërë nga KPMM-ja që nga fillimi i vitit 2006, rezistenca e bizneseve të vogla për pagesën e kësaj takse ka qenë e madhe, ndërkohë që as prodhimet e tyre nuk kanë qenë të mëdha. E vetmja kompani që ka pasur një prodhim më të madh të mineraleve ka qenë KEK-u, por duke llogaritur gjendjen e rëndë financiare të kësaj kompanie, as aty nuk ka pasur një inkasim të kënaqshëm. Po ashtu, as lartësia e rentës minerare për qymyr nuk është shumë e lartë, sepse i është kushtuar kujdes që mos të rrezikohet funksionimi i kësaj ndërmarrje. Ndikimi i rentës minerare është rritet dukshëm në vitin 2008, sepse në fund të vitit 2007 janë lëshuar në prodhim dy miniera të nikelit, si edhe katër miniera të tjera të Trepçës, ndonëse me një prodhim të kufizuar. Në vitin 2009 kemi pas një ulje të lehtë të të hyrave vetanake në raport me vitin 2008, për arsye të uljes së çmimit të metaleve në bursën e Londrës dhe të krizës financiare. Në vitin 2010 kemi pasur një rritje rekord të të hyrave, sepse çmimi i metaleve në bursë është stabilizuar dhe po ashtu edhe Sharr Beteiligungs GmbH është futur në sistem të pagesës po në këtë vit.

Me anë të rentës minerare mund të stimulohen edhe shfrytëzimet e mineraleve të caktuara. Për shembull, në Kosovë, në bazë të disa studimeve dhe analizave, është konstatuar së “guri i fortë” nga shkëmbinjtë gëlqerorë është më kualitativ për përdorim në ndërtimtari sesa rëra e cila nxirret nga lumenjtë. Me planin e Guroreve të Kosovës, të punuar nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, është vërtetuar së Kosova ka

³³ Raporti Vjetor i KPMM-së për vitin 2010

rezerva të mjaftueshme të gurit gëlqeror, ndërsa në anën tjetër ka dalë kërkesa nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor që të mbrohen lumenjtë nga shfrytëzimi i rërës. Për shkak se po bëhet degradimi i shtratit të lumenjve, është vendosur që renta minerare për “Rërë dhe Zhavori” të jetë 150 % më e lartë sesa renta minerare për shfrytëzim të “Gurit Gëlqeror”.

Duhet përmendur se në shumicën e vendeve të botës renta minerare nuk llogaritet si e vetme, apo e ndarë nga taksat e tjera. Për të kalkuluar rentën minerare qeveritë kanë parasysh edhe të gjitha taksat e tjera, duke filluar nga përfitimet e pronarit të tokës, përfitimet e komunitetit, tatimin në fitim etj.

6.4. Ndikimi i rentës minerare në tërheqjen e investimeve të huaja

Meqenëse mineralet janë pronë e shtetit, është shumë e qartë se qëllimi final i shtetit është maksimalizimi i përfitimit nga resurset minerare. Mirëpo, ngritja e shkallës së rentës minerare nuk do të thotë edhe maksimalizim i përfitimit, sepse nëse vendosim rentë minerare të lartë, atëherë do të kemi investime më të vogla në këtë sektor. Çdo investitor qëllimin e tij e ka profitin, prandaj është një mjeshtri e veçantë që të gjendet një optimum i shkallës së rentës minerare, me anë të së cilës do të përfitojë vetë shteti, si dhe në të njëjtën kohë të këtë investime në këtë sektor.

Nga praktika e disa vendeve të cilat e kanë shkallën e rentës minerare të ndryshme për mineralin e njëjtë, mund të vërejmë se edhe në ato vende shteti e ka përfitimin e vet. Mirëpo, këtë përfitim nuk e realizon direkt nga renta minerare, por duke aplikuar një shkallë më të ulët të rentës minerare për mineralet që përpunohen në vend apo përdoren në vend. Në këtë mënyrë shteti arrin të krijojë përfitime nga numri më i madh i të punësuarve dhe nga tatimet tjera që aplikon në vend.

Nga investitorët preferohet që shkalla e rentës minerare të caktohet në fillim, para se të fillohet me investime në sektorin e minierave, sepse kjo tregon një qartësi shumë më të madhe për kompanitë të cilat i përgatisin projektet e tyre investive për këtë lëmi.

Mirëpo, caktimi i rentës minerare nga shteti mund të përdoret edhe si politikë e tërheqjes së investimeve dhe orientimit të tyre në shfrytëzimin e mineraleve të caktuara. Nga shumë ekspertë të këtij lëmi rekomandohet që në fillim shkalla e rentës minerare të mos jetë shumë e lartë, në mënyrë që të bëhet tërheqja e investimeve, ndërsa pasi që kompanitë e fuqishme të kenë investuar, atëherë të bëhet një ngritje graduale e rentës minerare deri në atë nivel që nuk rrezikon humbjen e investitorëve kryesorë. Rritja e rentës minerare do të ndikojë në largimin e një numri të investitorëve, mirëpo nëse nuk rritet mbi nivelin e normales, atëherë do të ikin vetëm ato kompani që mund të konsiderohen si investitorë joseriozë.

Prandaj, që të gjendet bilanci i rentës minerare në nivelin e kënaqshëm edhe për investitorin edhe për shtetin, nuk është një gjë shumë e lehtë dhe kërkon një analizë të studiuar në mënyrë sa më të mirë për të dy palët.

7. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Konkluzione

Bazuar në studimet e bëra gjatë përgatitjes së këtij raporti mund të konstatohet se:

- **Ndikimi i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale në menaxhimin e resurseve minerare është i madh, duke filluar nga orientimi i tërheqjes së investimeve të huaja në territorin e Republikës së Kosovës. Pra, përveç ndikimit në zhvillimin e industrisë minerare, komisioni bën edhe implementimin e politikave të qeverisë në zhvillimin e sektorit minerar.**

Përveç Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, ndikim të konsiderueshëm në menaxhimin e resurseve minerare kanë edhe:

- **Ministria e Energjisë dhe Minierave, e cila merret direkt me përcaktimin e politikave të sektorit minerar si dhe të strategjisë së minierave;**
- **Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, e cila është përgjegjëse për Ambientin, duke filluar nga caktimi i zonave që janë me interes të veçantë e deri te dhënia e Pëlqimeve Ambientale apo Vlerësimi në Ndikimin në Mjedise të operimeve minerare;**
- **Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, konkretisht Agjencioni Pyjor i Kosovës që i menaxhon të gjitha pyjet; komunat, me përgatitjen e planeve zhvillimore komunale etj.**

Rekomandime

Në bazë të studimit të bërë gjatë hartimit të këtij raporti, mund të rekomandohet si më poshtë:

- **Mungesa e politikave të qarta për zhvillimin e sektorit minerar dhe mungesa e strategjisë minerare po ashtu është një problem që duhet të zgjidhet sa më shpejt. Në mungesë të politikave të qarta për zhvillim të sektorit, Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale është duke vazhduar që të bëjë licencimin e kompanive në përputhje me kriteret e parapara me ligj. Mirëpo, respektimi vetëm i ligjit përsëri nuk mjafton që të arrijmë më të mirën për Kosovën, sepse nevojitet të definohen zonat e mbrojtura për operime minerare, politikat e qarta për formën e trajtimit të ndonjë minerali të caktuar etj.**
- **Të bëhet vlerësimi i të gjitha guroreve në Kosovë dhe përgatitja e politikave të qarta për orientimin e shfrytëzimit nëpër zonat të cilat konsiderohen nga ekspertët si zona të përshtatshme për zhvillimin e këtyre veprimtarive.**
- **Ka nevojë urgjente që të themelohet “Shërbimi Gjeologjik i Kosovës”, si agjencion i veçantë i cili agjencion me Ligjin e Minerave duhet t’i raportojë Ministrisë së Energjisë dhe Minerave, dhe hulumtimet gjeologjike t’i hiqen nga barra Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale. Ky shërbim do të duhej ta ndihmojë Ministrinë e Energjisë dhe Minerave, tash Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, në përgatitjen e politikave zhvillimore në sektorin minerar.**
- **Bazuar në hulumtimet e bëra gjatë hartimit të këtij punimi, rekomandohet që bashkëpunimi ndërmjet institucioneve të jetë më i madh, duke filluar nga MMPH-ja, MEM-i, APK, AKP-ja, Komunitat etj., në mënyrë që shfrytëzimi i resurseve minerare të bëhet konform rregullave dhe ligjeve në fuqi.**
- **Pas analizimit të formës së promovimit të sektorit minerar, mund të konkludohet se janë bërë shumë promovime të ndryshme, të cilat janë në harmoni me metodat e tërheqjes së investimeve, mirëpo si vërejtje është mungesa e përgatitjes së institucioneve për t’iu përgjigjur kërkesave të investitorëve.**

Prandaj, rekomandohet që para se të fillohet me promovim duhet të hartohen dokumentet bazë për zhvillimin e sektorit, siç janë: politikat për zhvillimin e sektorit minerar, strategjia minerare, të kompletohet legjislacioni sekondar etj.

- **Pas përfundimit të konferencave nuk janë përcjellë kontaktet me kompanitë, nuk janë publikuar projektet të cilat janë prezantuar në konferenca, nuk**

janë shpallur tenderë për resurse dhe kjo ka rezultuar me një joseriozitet të madh të Kosovës karshi investitorëve.

Prandaj, rekomandohet që të përgatiten dokumentet për tenderim të zonave të interesit të shpallura nga Ministria për Energji dhe Miniera, me vendimin Nr. 1071 të datës 02.07.2008, ndërsa me datën 26.01.2009 merr vendim për plotësimin e vendimit të parë me zgjerimin dhe shpalljen e zonave të reja Nr. 125. Pas përgatitjes së këtyre dokumenteve të publikohet tenderi dhe menjëherë të organizohet një konferencë e re për promovim të zonave të cilat publikohen. Para publikimit dhe para konferencës duhet të kryhen të gjitha procedurat në mënyre që mos të vije deri te dështimi eventual i tenderëve dhe të kemi një zhgënjim të ri të investitorëve.

LITERATURA

1. A. Eëheeler dhe A. Muja, Resurset minerale të Trepçës dhe studimet e rezervave, (Shtator 2002)
2. B. MEHMETI, prof. Ordinar, METODAT E HULUMTIMEVE KËRKIMORE-SHKENCORE
3. B. SHABANI, Linjitet e Dukagjinit, rezervat dhe vlerësimi i tyre, Mitrovicë 1980
4. Beak Consultants, Metalogenic map of Kosovo, (Freiberg, 2008)
5. C. Legler, Beak Consultants, Kosovo Quarry Plan (Freiberg, 2006)
6. Grup Autorësh, Projekti shtesë i xehetarisë i ajrimit të minierës “Crnac”, (Kopaonik, Maj 1983)
7. I. Kuka , J. Shiroka-Pula, B. Krasniqi, Menaxhmenti dhe Vendosja , Prishtinë. (2006)
8. I. Nako, Bazat e Artit Minerar (Tiranë 1981),
9. Kolektiv autorësh, ripunuar nga Autori: Haxhi Sauku, S. Gugja, Aldorf. I., NDËRTIMI I PUNIMEVE MINERARE II-V, Konstruksionet mbajtëse dhe pajimet e punimeve minerare, (Tiranë, 1985)
10. M. Limani, Politika Ekonomike, Prishtinë (1994)
11. R. Abrashi, AJRIMI i MINIERAVE - Enti i teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i KSAK-së, (Prishtinë, 1985)
12. R. Durchholz, RËE, Lignite Allocation, (Germany, 2006),
13. S. Guxha, Shfrytëzimi nëntokësor i vendburimit të mineraleve të dobishme, Botimi i I, II, III, (Tiranë 1984)
14. S. Kastrati, Teknologjia e shfrytëzimit nëntokësor (ligjërata), (Mitrovicë, FXM, 2003)
15. Sh. Kelmendi, Metodatat matematikore në Inxhinieri, Universiteti i Prishtinës, (Mitrovicë, 2006)
16. Z. Elezaj, Dr. A. Kodra, Gjeologjia e Kosovës, (Prishtinë, 2008)

